



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2525/1 Prot.

Shijak, më 12.05.2026

Lënda: Kërkesë për publikim vendesh të lira.

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT  
Tiranë

Bashkia Shijak ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Kadastrës Fiskale ”.

Për këtë arsye, në përputhje me Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në bazë e në zbatim të tij, kërkojmë publikimin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI  
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2525 Prot.

Shijak, më 12. 05 .2026

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJE NË DETYRË**

Lloji i diplomës “ Ekonomik , Drejtësi , Administrim Publik ” , niveli i diplomës “ Master Shkencor ”

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015 të Këshillit të Ministrave “ Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese ” Bashkia Shijak shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin :

- 1 Përgjegjës  
në Sektorin e Kadastrës Fiskale ,Kategoria e pagës III – 3

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se për këtë pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se vendi është perseri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës se ngritjes në detyrë .

Për të dyja procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë )  
aplikohet në të njëjtën kohë!

<b>Afati për dorëzimin e Dokumenteve:</b> <b>22 .05.2026</b>	<b>Lëvizje paralele</b>
<b>Afati për dorëzimin e Dokumenteve:</b> <b>29.05.2026</b>	<b>Ngritje në detyrë</b>

## Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Siguron regjistrimin dhe aksesin e plotë në Sistemin Informativ të Kadastrës Fiskale, duke garantuar përdorimin korrekt dhe të sigurt të tij;

Kryen përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave, si dhe monitoron funksionalitetin e sistemit;

Organizon dhe realizon mbledhjen e të dhënave nga terreni, përmes verifikimeve fizike dhe burimeve të tjera administrative, me qëllim pasqyrimin e saktë të gjendjes së pasurive;

Administrojnë procesin e identifikimit të subjekteve tatimpaguese, duke përfshirë individët, personat fizikë dhe juridikë vendas apo të huaj, që janë pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Kryen llogaritjen e taksës mbi ndërtesat në përputhje me metodologjinë e miratuar me VKM nr. 132, datë 07.03.2018;

Bën klasifikimin e ndërtesave sipas përdorimit, duke aplikuar normat përkatëse të taksës:

0.05% për ndërtesat me destinacion banimi;

0.2% për ndërtesat që përdoren për veprimtari ekonomike;

Aplikon koeficientët përkatës sipas kategorive të ndërtesave, mbi çmimin mesatar referues, në përputhje me Aneksin 1 të VKM nr. 132/2018;

Siguron saktësinë dhe transparencën në përlllogaritjen e detyrimeve fiskale, duke respektuar legjislacionin në fuqi;

Bashkëpunon me strukturat e tjera të bashkisë dhe institucionet përgjegjëse për të garantuar mbledhjen efektive të të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat;

### I-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon .
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Mastër shkencor”, në degën “Ekonomik, Drejtësi, Administrim Publik”
- b) Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b) <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 22.05.2026**

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 26 .05.2026 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## 1.4

## FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar .
- d) Njohuritë mbi Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore “ , i ndryshuar .
- e) Njohuritë mbi Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar .
- f) Njohuritë mbi Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar .

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Shijak do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

## **2- NGRITJA NË DETYRË**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

## **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN**

## E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar ;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- c) Të ketë të paktën një vlersim pozitiv

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- g) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master shkencor “ Ekonomi, Drejtësi , Administrim Publik ” .
- a) Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- d) Te ketë 3 ( tre ) vjet përvoje pune në nivel ekzekutiv ,

### 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b) <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës;
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29.05.2026, në Institucionin Bashkia Shijak.**

### 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 02.06.2026 ,njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak , ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

**2.4**

#### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- k) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- l) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- m) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar .
- n) Njohuritë mbi Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore “ , i ndryshuar .
- o) Njohuritë mbi Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar .
- p) Njohuritë mbi Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar .

**2.5**

#### **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;

**2.6**

#### **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Shijak do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

**KRYETARI**  
**Elton Arbana**